



REPUBLIKA E KOSOVës  
KOMUNA E LIPJANIT

Pranuar më: Prilje:	08.09.2022
Njësia Jednica	Shtojca Dodatak
1-660103-48537	



Teach For Kosova dhe Komuna e Lipjanit nënshkruan këtë:

## MEMORANDUM MIRËKËPTIMI

Bazuar në Ligjin Nr. 03/l-040 për Vetëqeverisjen Lokale, **Teach For Kosova** dhe **Komuna e Lipjanit, përkatësisht Drejtoria e Arsimit** u pajtuan të bashkëpunojnë rreth zbatimit të programit të Teach For Kosova në Komunën e Lipjanit; për implementimin e projektit "Promovimi i të menduarit kritik dhe kohezionit multi-etnik tek të rinjtë", në kuadër të fushës së demokracisë dhe shoqërisë civile me përkrahje financiare të National Endowment for Democracy (NED) për krijimin e grupeve të debatit të shkollave të mesme në Komunë; si dhe asistimit nga ana e Komunës për realizimin e projektit në mënyrë sa më cilësore duke filluar nga Tetor 2022 deri Dhjetor 2023.

**Me anë të këtij Memorandum Mirëkëptimi, Teach For Kosova zotohet që brenda kësaj periudhe të implementimit:**

- Do të filloj të punoj në krijimin e grupeve të debatit edukativo-arsimor sa më gjithëpërfshirës dhe kualitativ për nxënësit e Komunës së Lipjanit;
- Do të filloj punën në dy shkollat e mesme: SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan dhe SHML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan, p.n.f në Gadime.
- Teach For Kosova do të përgatisë nxënësit për gjatë kësaj periudhe për zhvillimin e mendimit kritik dhe aktivizmin qytetar.
- Teach For Kosova siguron që kandidatët, të cilët e përfundojnë periudhën e debateve joformale, do të bëjnë punë të jashtëzakonshme brenda debateve me nxënës, e të cilët do të kontribuojnë në mobilizim të komunitetit të shkollës.
- Organizon aktivitetin "Libri i gjallë", ku nxënësit tanë realizojnë pjesën praktike të përgatitjes së tyre në bisedë me një person që ata e përzgjedhin dhe e shfletojnë si libër, me pyetjet e tyre, në një ambient në qytet.;
- Organizon aktivitetin "Natën e filmit dokumentar", ku grupi i debatit do të ketë mundësi të përcjellë një film ose dokumentar edukues e mandej të reflektojë/debatoj lidhur me të.
- Organizon aktivitetin "Dëgjimin publik me Kryetarin e Komunës" ku nxënësit do të kenë rastin të bisedojnë me kryetarin për rreth dy orë.
- Organizon garat e debateve brenda komunës dhe shkolla fituese garon me shkollën fituese të komunës tjetër.
- Teach For Kosova si organizatë joqeveritare siguron që temat të cilat do të shtjellohen nga nxënësit në debate nuk kanë kahje politike;

**Ndërsa, Komuna e Lipjanit zotohet se:**

- Asiston në identifikimin e nevojave të nxënësve për debat, përzgjedhjen e temave ose nxënësve, vetëm nëse shihet nevoja për një gjë të tillë;
- Mundëson qasjen e Teach For Kosova në shkollat e përmendura të mesme për qëllime monitorimi dhe matje të performancës së debateve dhe sigurimin e hapësirës;
- Ndihmon dhe lehtëson takimet e stafit të Teach For Kosova me palët e interesit siç janë: Zyrtarët komunal, drejtorët e shkollave, mësuesit, nxënësit e prindërit dhe koordinatorët e cilësisë;



- Ndhomon në organizime potenciale të eventeve të ndryshme në Komunën përkatëse, për të raportuar apo shpërndarë punën e Teach For Kosova;

### Komunikimi

Çdo komunikim lidhur me mbarëvajtjen e debateve dhe realizimin sa më të mirë të projektit do të bëhet mes zyrtarit të DKA-së dhe menaxheres së projektit:

- Komuna e Lipjanit:  
Teuta Berisha– Zyrtare në DKA  
Emaili: [t-berisha@hotmail.com](mailto:t-berisha@hotmail.com)
- Teach For Kosova:  
Valmira Morina – Menaxhere e projektit  
Emaili: [valmira.morina@teachforkosova.org](mailto:valmira.morina@teachforkosova.org)

Përmes këtij Memorandum Mirëkuptimi, Komuna e Lipjanit dhe Teach for Kosova pranojnë njëra-tjetrën si partnere zhvillimore në fushën e arsimit parauniversitar, dhe inkurajojnë të gjitha palët e interesuara që gjithashtu të mbështesin programin e lartshënuar. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dy palët, dhe vlen vetëm për periudhën e implementimit të projektit dhe nuk vlen dhe nuk mundet të përdoret për qëllime tjera.

Në emër të Teach For Kosova:  
Egzon Gashi, Drejtor Ekzekutiv

Teach  
for  
Kosova

Në emër të Komunës së Lipjanit:  
Kryetari, z. Imri Ahmeti,

